




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1114 Prot

Nr. 1657/1 Dosje

Tiranë, më 04.06.2018

URDHËR

PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB - TIRANË)

Unë, Florian Shehu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit "TDR GROUP" sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.2060, të lëshuar me datë 09.03.2018 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.1657/1, Datë 10.04.2018 kërkesën e kreditorit Subjekti "Saip Bizgjoni" person fizik, me NIPT K61718001W ndaj debitorit Shoqëria "A.G.E. CO & CO" Sh.p.k, me NIPT K31413048A në lidhje me titullin ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje Nr.06, Nr. Serie 18831088, datë 31.01.2017; Faturë Tatimore Shitje Nr.07, Nr. Serie 18831089, datë 02.02.2017.

Pasi është filluar procesi i ekzekutimit të detyrueshëm, në referim të dispozitave të K.Pr.Civile, me Shkresën Nr.756 Prot., datë 23.04.2018 është dërguar Qendrës Kombëtare të Biznesit – QKB, Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga Shoqëria "A.G.E. CO & CO" Sh.p.k, me NIPT K31413048A.

Sa më sipër,

KONSTATOVA

Se pasi u studiuan materialet e dosjes përmbarimore në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit Nr.2060, të lëshuar me datë 09.03.2018 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me datë 28.05.2018 është arritur Marrëveshja ndërmjet kreditorit dhe debitorit për shlyerjen e detyrimit sipas parashikimeve të marrëveshjes. Nga ana e Shoqërisë "A.G.E. CO & CO" Sh.p.k, me NIPT K31413048A është depozituar në llogarinë bankare të Shoqërisë së Përmbarimit "TDR GROUP" sh.p.k kësti i parë për shlyerjen e detyrimit ndaj kreditorit Subjekti "Saip Bizgjoni" person fizik, me NIPT K61718001W.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura, në referim të neneve 527 dhe 528 të Kodit të Procedurës Civile, neneve 31, 34 të Ligjit Nr.10031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat";



URDHËROJ

1. Qendra Kombëtare të Biznesit (QKB – Tiranë) të lirojë nga masa e sekuestros konservative të gjitha aksionet e zotëruara, të cilat rezultojnë të jenë regjistruar në emër Shoqëria "A.G.E. CO & CO" Sh.p.k, me NIPT K31413048A, të bllokuar me anë të shkresës Nr.756 Prot., datë 23.04.2018 të Shoqërisë së Përmbarimit "TDR GROUP" sh.p.k.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare të Biznesit (QKB – Tiranë) për zbatimin e këtij urdhri.
3. Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
4. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në dispozita ligjore, palët mund të paraqesin ankim në Gjykatë, 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhri.
5. Ky urdhër mbahet në disa kopje dhe u njoftohet palëve të interesuara.

SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

FLORIAN SHEHU

